



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:087654

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05556145

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Blerina KURTAJ, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.R.M.” Ç...” sh.a., me seli në Gjakovë, kundër debitorit M.S., – Rr. “...” - Gjakovë lidhur me çështjen përmbarimore, për borxh, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori M.S., kundër urdhrin përmbarimor P.nr.641/19, datë 24.09.2019, të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Gëzim Gjoshi, në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, jashtë seancës, me 08 Prill 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht i bazuar prapësimi i debitorit M.S., – Rr. “... Gjakovë, dhe SHFUQIZOHET urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.641/19, datë 24.09.2019, të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Gëzim Gjoshi, në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, në shumë prej 679.75 euro, për shkak të parashkrimit të kërkesës nga data 31.01.2006 deri me datë 31.12.2017.

II. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit M.S., nga Gjakova, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit numër P.nr.641/19, datë 24.09.2019 të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Gëzim Gjoshi, në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, për shumën prej 93 euro, për periudhën nga data 31.01.2018 e deri me datë 31.09.2019.

III. Në rast se debitori parashtron ankesë, kundër këtij aktvendimi, URDHËROHET që në afat prej 7 ditëve nga dita e parashtrimit të ankesës, të paguaj garancionin në gjykatë në shumën prej 93 euro.

IV. Në qoftë se debitori dështon të paguaj shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, brenda afatit si në pikën -III- të këtij dispozitivi, ankesa e parashtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është parashtruar fare nga pala ankuese, tani debitore.

A r s y e t i m

Zyra Përbarimore e Përbaruesit Privat në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit KRM “Ç...” sh.a., me seli në Gjakovë, ka lëshuar urdhrin P.nr.641/19, datë 24.09.2019, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë ekstraktit të verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit, i cili është dokument i besueshëm në bazë të nenit 21 dhe 29 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPP).

Kundër urdhrimit për lejimin e përbarimit brenda afatit ligjor është ushtruar prapësimi nga debitori, në të cilin debitori e ka kundërshtuar propozimin për përbarim për shkak të parashkrimit pasi që ka kaluar afati ligjor për realizimin e kërkesës nga kreditori bazuar në nenin 360 të LMD ngase kanë kaluar më shumë se 17 vite. Ka propozuar që të pezullohet procedura për shkak të parashkrimit.

Kreditori brenda afatit ligjor nuk ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar.

Gjykata, fillimisht vlerësoi propozimin për përbarim të paraqitur nga kreditori dhe erdhi në përfundim se i njëjti është paraqitur konform dispozitës ligjore të nenit 38 të Ligjit për Procedurën Përbarimore Nr.04/L-139 (në tekstin e mëtejme LPP-së) dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara me këtë dispozitë, duke ia bashkëngjitur të njëjtit dokumentin e besueshëm në origjinal, në bazë të cilit kërkohet përbarimi, përkatësisht ekstraktit të verifikuar nga librat

afariste, i cili ekstrakt është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim, në kuptim të dispozitave të nenit 29 par.1 nën par.1.2 dhe par.3 të LPP-së, ku përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është: 1.1. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesën e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, tutje në paragrafin 3 të këtij nenin parashihet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Sa i përket pretendimit të debitorit, lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, gjykata duke bërë shikimin e shkresave të lëndës, përkatësisht propozimin për përmbarim të parashtruar tek Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë dhe i lejuar nga i njëjti me Urdhrin Përmbarimor P.nr.641/19, datë 24.09.2019 për borxh në vlerën prej 772.75 euro, për periudhën nga data 31.01.2006 deri me datën 30.08.2019, si dhe duke u bazuar në ekstraktin e verifikuar nga librat afarist, vlerësoj se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe të njëjtin e aprovoj pjesërisht si të bazuar në kuptim të nenit 71 par.1 nën par 1.4 të LPP-së, sipas të cilit parashihet se *“ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi”*, për shumën prej 679.75 euro, pasi që për detyrimet e krijuara prej datës 31.01.2006 e deri me datë 31.08.2019, është borxh i parashkruar konform nenit 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin theksohet se *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*. Andaj, për këtë pjesë të borxhit, pasi që kemi të bëjmë me shërbimet e mbeturinave dhe hyn në kategorinë e parashkrimit të kërkesave një vjeçare, gjykata vlerësoi se ka kaluar afati i paraparë me dispozitat e lartcekura – afati i parashkrimit, pas kalimit të së cilit afat, kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore marrë parasysh kundërshtimin e paraqitur nga këtu debitori, andaj edhe vendosi si në pikën -I- (një) të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendosja në pikën -II- (dy) të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit si të pa bazuar, erdhi pasi që për këtë pjesë të borxhit nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës sepse kreditorja e ka ndërprerë parashkrimin duke parashtruar propozim për përmbarim me datën 24.09.2019, bazuar në nenin 369 të LMD-së, ku theksohet se *“Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi,*

sigurimi ose realizimi të kërkesë”. Pra, pjesa e borxhit që përfshin periudhën nga data 31.01.2018 e deri me datë 31.08.2019, në shumë prej 93 euro, ka mbetur në fuqi, pasi që për këtë pjesë nuk ka arritur afati i paraparë me dispozitën e lartcekur për parashkrimin e kërkesës.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, po ashtu debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova, ashtu siç kërkohet me nenit 69 par.4 të LPP-së, në të cilin thuhet se *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, për ndryshe prapësimi do të refuzohet”*.

Gjykata vendosi sikurse në pikën -III- (tre) të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke urdhëruar debitorin, se në rast se parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, i njëjti ka obligim që në afatin prej 7 ditëve, nga momenti i parashtrimit të ankesës të deponoi garancinë në gjykatë, në shumën prej 93 euro dhe gjykatës t’ia dorëzoi provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit pranohet pjesërisht .

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm.

2024:087654, me 08 Prill 2024

GJYQTARJA

Blerina KURTAJ

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë Ankese në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.